

FJALË PËRSHËNDETËSE

*Fatos Nano**

Për mua është një privilegj t'i drejtohem këtij auditori shumë të rëndësishëm për qëndrueshmërinë e rritjes, për reformat strukturore dhe për ritmin e integritit të Shqipërisë në tregjet dhe ekonominë globale. Ju kam ndjekur në distancë. Bankat duhet të ruajnë një distancë nga qeveria, bankat duhet, veçanërisht ato qendrore, të edukojnë në distancë të gjithë aktorët sipërmarrës, sipërmarrës institucionalë dhe të tregut.

Po kthehem nga një ambient tjetër integrimi, nga Këshilli i Atlantikut të Veriut, i aleancës me të cilën ne po afrohem për integrim, që është një sinjal se ne të gjithë mund të punojmë në një ambient më të sigurtë jo vetëm rajonal, jo vetëm global, por edhe transadriatik, duke shfrytëzuar këtë pozicion të favorshëm që Perëndia i ka dhënë vendit në rrafshin qendror apo lindor të globit, në një urëkalim që po strukturohet për lëvizje më intensive mallrash, kapitalesh dhe iniciativash të sipërmarrjes edhe financiare midis Evropës Perëndimore dhe Azisë Qendrore. Edhe ndaj partnerëve të huaj, të pranishëm në këtë sallë, më lejoni që të bashkoj mirënjohjen e qeverisë për kontributet që ata japin në rritjen dhe konsolidimin e këtij partneriteti, midis institucioneve të pavarura financiare të Shqipërisë me botën moderne, ku ne integrohemi. Këto takime janë të rëndësishme edhe sepse po bëhen pjesë e axhendave tona të punës në këtë rajon të tregjeve globale. Më vjen mirë që takime të tilla

po specializohen, sepse janë gjithnjë e më profesionale. Kjo është një provë dhe një sfidë e vlerësimit, e matjes dhe e konsolidimit të aftësive tona për konkurrim, për partneritet, për iniciativa me të gjera se kufijtë e tregut nacional.

Unë besoj se dallimi është i madh edhe në këtë ambient të rikonstruktuar, ku jo shumë vjet më parë, natyrisht në një pamje të parikonstruktuar, bëheshin llogari piramidash, të cilat i krijuan një shock të vërtetë ekonomisë dhe shoqërisë sonë. Unë e vlerësoj këtë edhe si një mjedis shkencor, ku bota akademike, ajo e institucioneve financiare dhe e biznesit bankar, ballafaqojnë ide. Qeveria është e gatshme dhe thithëse ndaj tyre për të harmonizuar gjithnjë e më mirë politika ekonomike, në dobi të thellimit të reformave strukturore, të funksionimit më të mirë të tregjeve, të forcimit të stabilitetit financiar, si dhe të shtimit të aftësive dhe veprimeve tona për konkurrim në ballafaqimin e sistemit financiar kombëtar me atë global, në këtë proces integrimi.

Zhvillimi ynë është bërë i qëndrueshëm, është dinamik, përpiqet të kapë ritmet dhe sektorët e tregut bashkëkohor. Ne synojmë të jemi më konkurrues në këtë partneritet. Ne i kemi projektuar ekonomisë sonë një të ardhme ambicioze. Këto ambicie nuk mund të realizohen përveçse në një hapësirë më të gjerë, në një hapësirë që na bashkon me vendet e rajonit, jo vetëm nga pikëpamja e vendosjes gjeografike, por edhe e objektivave dhe e reformave për integrim evropian apo euroatlantik, dhe për pasojë, edhe për interesa kombëtarë, interesa biznesi. Pra, bashkohemi me rajonin dhe me ju në objektiva afatmesëm dhe afatgjatë, janë edhe objektiva globale, janë edhe objektiva sektoriale.

Jam këtu për të ndarë me ju prioritetet e axhendës së reformave strukturore që sintetizojnë programin qeverisës. Të gjitha këto kërkojnë vendimmarrje të guximshme dhe sipërmarrje të strukturuar. Ne duam që zhvillimi ynë i qëndrueshëm jo vetëm të kurojë varfërinë dhe të integrojë komunitetet dhe resurset në tregun kombëtar, por dhe të bëhet kompetitiv, të profilizohet dhe së bashku me instrumentet, politikat dhe interesat bankarë, të na japin mundësinë të ndërtojmë profilin dhe portofolin e Shqipërisë në ndarjen rajonale dhe globale të punës në tregjet që po globalizohen.

Banka e Shqipërisë në krye të sistemit bankar të vendit është gjithashtu, e përfshirë në këto sfida kombëtare për zhvillim të qëndrueshëm dhe për konkurrim që shoqërojnë ritmet e integritit. Duket se ne kemi vlerësime komplementare dhe koherente me njëri-tjetrin, që forcimi i kapaciteteve qeverisëse të vendit apo i administrimit publik, forcimi i autoritetit të ligjit apo i agjencive që forcojnë zbatimin e ligjit, të shoqërohet me ritme më logjike dhe më të orientuara, në reformat strukturore, në reformat e tregut, në reformat financiare, në marrëdhëniet e bankave me pjesën tjetër të ekonomisë dhe të tregjeve. Ne duam që kjo të ndihmojë, të bëjë më funksionale, më koherente dhe më me të ardhme marrëdhëniet e Qeverisë së Shqipërisë me institucionet financiare ndërkombëtare, me FMN dhe me BB.

Shqipëria është maturuar mjaftueshëm për shkak të bashkëpunimit me këta lider të tregjeve financiare botërore dhe për pasojë, ne duam edhe mbështetjen dhe bashkëpunimin me Bankën Qendrore të Shqipërisë, me komunitetin e bankave të Shqipërisë, për të hyrë në një etapë të re, në një marrëveshje të re që do t'i jepte më shumë hapësira dhe fleksibilitet zhvillimit të qëndrueshëm të vendit.

Marrëveshja e ardhshme me FMN mbështetet në këtë progres të qartë dhe që bëhet i qëndrueshëm, për shkak të reformave të sukseshme strukturore dhe institucionale, mbështetet në qëndrueshmërinë e tregjesve makrofikale, në rritjen e kapaciteteve administruese jo vetëm në administrimin publik në tërësi, por dhe në atë fiskal në veçanti, në rritjen e transparencës dhe të përgjegjshmërisë së vendimarrjes në të gjitha nivelet, për shkak se respekti ndaj marrëveshjeve që ne kemi me institucionet financiare ndërkombëtare apo vendase, tashmë shtrihet në të gjithë aktorët që përfshihen në këtë proces, sepse disiplina e tregjeve financiare moderne po bëhet parametër i administrimit publik. Ne e shohim këtë si një nga instrumentet dhe komponentët themelorë të afrimit tonë për integrim me Bashkimin Evropian. Nuk mund të nënvlerësojmë bashkëpunimin me bankat dhe me institucionet financiare ndërkombëtare, për shkak të dobësisë së kapaciteteve apo të nevojave për të forcuar veprimin proaktiv me agjencitë apo me institucionet e Bashkimit Evropian. Këto janë dy procese komplementare dhe ato do të zëvendësojnë apo plotësojnë natyrshëm njëri-tjetrin në konsolidimin e rritjes dhe të profilit tonë në integrimin global.

Ne po vazhdojmë të rishikojmë kuadrin ligjor dhe atë nënligjor, veçanërisht në mbështetje të krijimit të gjithë mjedisit, kushteve dhe të instrumenteve që favorizojnë dhe mundësojnë anëtarësimin edhe në fushën e sistemit bankar dhe financiar, në bashkësinë evropiane. Ne e shohim këtë edhe si një prerogativ dhe imperativë edhe për Bankën Qendrore. Prandaj jeni të mirëpritur, ju dhe të gjithë partnerët e sistemit bankar në Shqipëri, që është 98 për qind privat, në iniciativa, që na bashkojnë për ta vazhduar perfeksionimin e kuadrit ligjor për të bërë më konkurruese dhe më bashkëkohore sistemet dhe portofolet financiare dhe bankare, për t'i hapur rrugë më efektive mbikëqyrjes së këtyre sistemeve, për të nxitur forcimin e bashkëpunimit institucional midis sistemit bankar dhe sistemit financiar, për të kapur standardet edhe në këto fusha sensitive.

Duhet theksuar se Banka e Shqipërisë ka luajtur dhe duhet të luajë pa dyshim rolin kryesor në formimin dhe konsolidimin e sistemit bankar në vend, si dhe në asistimin e Qeverisë në hartimin dhe zbatimin e reformave që afektojnë tregun bankar dhe financiar. Qeveria e ka konsideruar dhe e konsideron Bankën e Shqipërisë si një partnere të denjë edhe në fushën e këshillimit dhe gjej rastin të falenderoj këtë institucion që, edhe kur përtërihet, konsolidon përvojën dhe shpreh ambicie më të qarta për të vazhduar këtë bashkëveprim nxitës me qeverinë dhe me institucionet e saj të specializuara.

Banka e Shqipërisë tashmë ka eksperiencën dhe kapacitetet e duhura për të rritur rolin dhe ndikimin e saj në zhvillimet ekonomike të vendit, si partner ligjor i qeverisë, si një institucion shumë i rëndësishëm dhe i pavarur i shtetit. Roli juaj përputhet me iniciativat tona në prioritete të rëndësishme si lufta ndaj ekonomisë cash, ndaj evazionit fiskal dhe veçanërisht një program koherent që na bashkon në kurimin dhe në moslejimin përfundimisht të fragmentarizimit të kapitaleve publike apo private në treg. Të gjitha këto prioritete nuk do të mund të realizohen pa një angazhim të drejtpërdrejtë dhe një bashkëpunim më të ngushtë mes Qeverisë dhe Bankës së Shqipërisë. Me këtë nuk po kërkohet që Banka e Shqipërisë të heqë dorë nga prerogativat tuaja të integritetit dhe pavarësisë, por ju ftoj të lubrifikojmë më mirë mekanizmat e konsulencës, të asistencës dhe të bashkëpunimit, që do të na çonin më shpejt tek formalizimi i tregut kombëtar në tërësi dhe tek transparenca për të gjithë aktorët privatë

vendas dhe të huaj, që vlerësojnë asetet dhe kapacitetet tona për rritje të qëndrueshme dhe për partneritet dhe sipërmarrës.

Ne duhet të programojmë së bashku zhvillimin e një ekonomie të strukturuar dhe formale të tregut, me një sistem bankar dhe financiar që nuk rresht së krijuari stimuj për zhvendosjen e parave dhe transaksioneve financiare në banka, që orientojnë kursimet dhe kapitalet e fjetura në prioritetet zhvillimi të programuara dhe të qëndrueshme dhe koherente, në objektivat tanë evropianë apo në tregjet globale.

Ne do të vazhdojmë ta respektojmë si një gjë të shenjtë pavarësinë institucionale të Bankës së Shqipërisë, por ne besojmë se forcimi i mëtejshëm i kësaj pavarësie nënkupton shtimin e përgjegjësive që ndahen me të gjithë aktorët edhe në qeveri, sepse vetëm duke forcuar autoritetin që vjen nga përgjegjësia në treg rritet edhe pavarësia institucionale e bankës.

Për ne është shumë e rëndësishme në qeveri, të punojmë së bashku me ju për krijimin e një klime sa më të mirë për sipërmarrjen, edhe për sistemin bankar privat, për thithjen e parasë dhe orientimin e saj në multiplikator vlerë të re me programe koherente, me paketa afariste dhe jo me tryeza boshe apo me propagandë parrullash. Ne nxisim dhe kërkojmë të punojmë së bashku për të krijuar struktura më të qëndrueshme të sipërmarrjes, të biznesit, struktura më të qëndrueshme pagesash, shërbime bankare dhe financiare të parametrave konkurrues dhe bashkohorë. Natyrisht, kjo lidhet shumë edhe me marrëdhëniet direkte të bankave me biznesin, të cilat po zhvillohen, po krijojnë një klimë tjetër bashkëpunimi dhe po e sjellin sistemin bankar me shërbimet e tij më në vëmendje dhe më në kërkesë të të gjithë sipërmarrësve, pranë klientelës, më i përdorshëm jo vetëm për qeverinë por edhe për tradicionalistët e ekonomisë cash.

Bankat po e rrisin praninë e tyre në të gjithë vendin dhe më vjen mirë që askush prej protagonistëve të sistemit bankar privat nuk ndjehet i shqetësuar kur edhe unë kam bërë pyetjen për rreziqet e konkurrencës që shtohet dhe konsolidohet. Bankat po e bëjnë më të shëndetshme sipërmarrjen dhe po na bëjnë edhe ne më të

vëmendshëm në politikat ekonomike dhe financiare. Bankat po riinvestojne kapitalin e tyre në teknologji të reja dhe po krijojnë një rrjet të gjerë pagesash. Modernizimi i sistemit të pagesave po na jep dhe do të na japë akoma më shumë në të ardhmen, kontribute reale në uljen e ekonomise cash dhe të asaj informale. Pra, ne na bashkon interesi për të krijuar një infrastrukturë bashkëkohore të pagesave dhe me kënaqësi konstatojmë se përpjekjet e sistemit bankar po njohin progres të kapshëm dhe të prekshëm në këtë drejtim. Bankat tona po bëhen pjesë e rrjeteve të mëdha ndërkombëtare të kartave, qytetarët shqiptarë po mësohen me pagesat me karta dhe ne do të nxisnim gjithashtu, të ecet drejt profilit edhe të një karte kombëtare, ku besoj se secila nga bankat do të ketë *share*-n e saj.

Unë jam shumë i stimuluar gjithashtu, nga ritmet me të cilat po rritet fluksi i kreditimit të bankave private në ekonomi. Natyrisht, jam shumë i vëmendshëm për të përmirësuar edhe marrëdhëniet e kreditimit apo të huamarrjes së qeverisë me Bankën Qendrore. Unë besoj se të dy komunitetet, edhe bankat edhe sipërmarrja, kanë nevojë për një rol më efikas dhe aktiv të Bankës së Shqipërisë jo vetëm për një ambient të sigurt makroekonomik, por edhe për të nxitur më tej dhe orientuar më drejt, në mënyrë më koherente aktivitetet kredituese dhe vetë biznesin drejt projekteve dhe investimeve më të sigurta, që përkojnë me negociatat ose me marrëveshjet që qeveria nxit apo realizon me institucionet financiare ndërkombëtare apo me kompani globale, që shfrytëzojnë të gjithë hapësirën e tregut, prandaj punojnë dhe me qeverinë, për të siguruar një rritje të qëndrueshme dhe një profil konkurrues të Shqipërisë në ekonominë rajonale dhe më gjerë.

Unë jam këtu për ta nxitur dhe më tej sistemin bankar, që të shkojë edhe më afër popullsisë dhe sipërmarrjes me produkte të qarta dhe të gatshme, me shërbime të shpejta dhe efikase. Unë e nxis dhe e mbështes vokacionin e Guvernatorit Fullani dhe të Bankës së Shqipërisë, për të zgjeruar dhe shtuar analizat e tregut, të kapaciteteve, të treguesve të stabilitetit ekonomik dhe financiar dhe të rritjes më të qëndrueshme ekonomike të vendit.

Si Kryeministër, më lejoni të nderuar bankierë, të kërkoj më shumë kontribute për një rol më aktiv dhe më cilësor në performancat e

tregut. Ndaj me ju bindjen se progresi i sistemit bankar të Shqipërisë nuk mund të vlerësohet vetëm me uljen e rrezikut të kthimit të kredive, por me portofolin e kredive që ky sistem injekton në ekonominë dhe sipërmarrjen kombëtare. Për mua, roli i bankave është dhe po bëhet gjithnjë e më jetik për rritjen ekonomike nacionale dhe për aftësitë konkurruese të sipërmarrjes sonë, në ballafaqim me ekonominë dinamike të rajonit dhe të botës.

Shqipëria gjithashtu po i largohet, për shkak të dinamikës së rritjes dhe të shtimit të instrumenteve të tregjeve globale në tregun e brendshëm, nivelit të vendeve që përfitojnë kredi dhe donacione me terma të butë nga organizma financiarë ndërkombëtarë apo banka zhvillimi. Ky është një moment reflektimi proaktiv që na bashkon jo vetëm në vlerësimin e ecurisë së reformave deri më sot, por edhe në detyrimet e reja që na lindin në veçanti për qeverinë dhe Bankën e Shqipërisë, për të racionalizuar kontratat huamarrëse apo kufijtë e borxhit, për të reduktuar më tej borxhin e brendshëm dhe atë të huaj, për të përballuar më me sukses kostot e stabilizim - asociimit, duke u mbështetur në një partneritet më efikas në sistemin bankar dhe financiar, për të mobilizuar më plotësisht kapitalet e brendshme, duke i orientuar në programe investimesh prioritare zhvillimi dhe duke e bërë më tërheqëse klimën e thithjes së investimeve të huaja direkte.

Për këtë shkak, ne po angazhohjmë edhe kompani të specializuara dhe unë nuk do t'i shmangem sfidës së paraqitjes bashkë me to të portofoleve dhe të potencialeve që ne ofrojmë për kompani gjithnjë e më përfaqësuese nga ekonomia globale, që po trokasin në dyert e tregjeve tona që po hapen.

Si Kryeministër, unë e ftoj Bankën e Shqipërisë si partner ligjor, të punojmë me ritëm dhe me koncepte më të programuara bashkërisht, për të krijuar të gjitha instrumentet dhe institucionet që orientojnë më saktë parandë dhe kapitalet vendase në sektorët më produktivë dhe më konkurrues të ekonomisë kombëtare, që natyrshëm po bëhet më vulnerabël në procesin e hapjes dhe të integritimit rajonal dhe global.

Më lejoni ta mbyll duke falenderuar Guvernatorin e Bankës së Shqipërisë për organizimin e këtij aktiviteti të rëndësishëm dhe për t'ju garantuar të gjithëve, në emër të qeverisë, se do të keni vëmendjen

dhe angazhimet tona maksimale dhe partneriale për të reformuar edhe më tej së bashku ekonominë kombëtare dhe për të sjellë, edhe në tregun financiar dhe bankar, standardet e integritit në Bashkimin Evropian.

* Fatos Nano: Kryeministër i Republikës së Shqipërisë.